



**REPUBLIKA E KOSOVËS**

**KOMUNA E VUSHTRRISË**

**Drejtoria për Ekonomi, Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural**

**Data e nënshkrimit të Marrëveshjes me Partecipim: 16.11.2018**

*Rr. "Adem Jashari" nr.1, tel. 028 571 524*

Duke u bazuar në nenin 17 pika a zhvillimi lokal ekonomik të Ligjit me **Nr.03/L-040**, si dhe Thirrjes për Aplikim të datës 04.07.2018, të shpallura nga Drejtoria për Ekonomi, Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, lidhë këtë:

### **MARRËVESHJE ME PARTICIPIM**

**Për projektin "Makina për nxjerrjen e patates"**

#### **E përpiluar në mes të:**

1. Komunës së Vushtrrisë të cilën e përfaqëson Kryetari i Komunës z.Xhafer Tahiri, në njërën anë në cilësinë e subvencionuesit dhe
2. Përfituesëve që kanë participuar për projektin **"Makina për nxjerrjen e patates"**

#### **Neni 1**

##### **Qëllimi**

Qëllim i lidhjes së kësaj marrëveshje me participim është përkrahja nga Komuna e Vushtrrisë në ngritjen e kapaciteteve në bujqësi-blegtori.

#### **Neni 2**

Lënda e kësaj marrëveshje është participimi vullnetar i përfituesëve, lidhur me sigurimin apo grumbullimin e mjeteve financiare të përfituesëve për realizimin e projektit **"Makina për nxjerrjen e patates"**, në bashkëfinancim me Komunën e Vushtrrisë si subvencionuese kryesore e këtij projekti.

#### **Neni 3**

Vlera e përgjithshme e mjeteve që duhet grumbulluar nga participimi i përfituesëve për realizimin e projektit nga neni 1 i kësaj marrëveshje me participim është në vlerën e përgjithshme prej **2,100.00 €**.

#### **Neni 4**

4.1 Vlera e mjeteve që ka siguruar Komuna si subvencionuese kryesor për realizimin e projektit lëndor është shuma prej **15,000.00 €**, ndërkaq që projekti të realizohet duhet që përfituesit të participojnë vullnetarisht me mjetet në vlerën e cekur në nenin 3 të kësaj marrëveshje.

4.2 Vlera e tërësishme e projektit nga neni 1 i kësaj marrëveshje është **17,100.00 €**

#### **Neni 5**

##### **Obligimet e Komunës**

Komuna merr për obligim që me sigurimin e mjeteve nga përfituesit të bëjë realizimin e projektit nga neni 1 i kësaj marrëveshje.

#### Neni 6

Në rast të mos grumbullimit të mjeteve Komuna gjegjësisht drejtoria për EBPZHR, do të bëjë stopimin e realizimit të projektit lëndor.

#### Neni 7

##### Obligimet e përfituesit

7.1 Përfituesit janë të obliguar të paguajnë shumën e participimit prej **700.00€**, në xhirollogari të Komunës, në cilëndo prej bankave afariste.

7.2 Përfituesit janë të obliguar që të respekton këtë marrëveshje.

7.3 Përfitueseve nuk ju lejohet që për tre(3)vite ta shesin, tjetërsojnë ose ta keqpërdorin subvencionin, në të kundërtën do të ndiqen penalisht.

#### Neni 8

Për ekzekutimin e kësaj marrëveshje kujdeset: Drejtoria e Prokurimit, Drejtoria për Ekonomi, Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa, nën mbikëqyrjen e Kryetarit të Komunës.

#### Neni 9

Kjo marrëveshje ka tretmanin e kontratës vullnetare në mes të palëve dhe e njëjta do të realizohet me përmbushjen e obligimeve nga ana e të dy palëve.

### P A L Ë T E M A R R Ë V E S H J E S

#### Subvencionuesi:

Komuna e Vushtrisë  
z.Xhafer Tahiri  
(Kryetar i Komunës)



#### Përfituesit

1.Xhafer Osmani Nr.personal:1003051095

2.Muharrem Maxhuni Nr.personal:1231999325

3.Sead Xhaferi Nr.personal:1241700735